



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 14, datë 19.02.2021

PËR
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER PROFESIONAL NË “BANKË-FINANCË”, TË UNIVERSITETIT
“ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 19.02.2021, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “**Bankë-Financë**”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Master Profesional në “**Bankë-Financë**”
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1161, datë 25.11.2009 , miratuar riorganizimi me shkresë të MASR Nr. 7243/1, datë 22.08.2018.
- d) Institucioni që e ofron: Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Financë Kontabilitetit
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 1 vit / 2 semestra
- g) Kredite (ECTS): 60 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
- j) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është **“i përmbush pjesërisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:
 1. Lëndët që përbëjnë kurrikulën e këtij programi studimi nuk janë në përputhje me nivelin e programeve të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional.
 2. Staf i akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi nuk mbulon në masën të paktën 70 % ngarkesën mësimore të programit të studimit.
 3. Mungesa e studimit të tregut të punës, për të analizuar punësimin e studentëve dhe për të përmirësuar programin e studimit.
 4. Bashkëpunim i dobët me bizneset apo punëdhënësit e fushës, për të kuptuar kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimin të studentëve, realizimin e praktikave profesionale etj.
 5. Mungesa e trajnimeve në kuadër të përmirësimit të procesit të mësimdhënies apo përmirësimit të kompetencave didaktike për stafin akademik me kohe të plotë dhe me kohë të pjesshme, të këtij programi studimi.
 6. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ka mungesë të burimeve njerëzore dhe pavarësisë, në realizimin e funksioneve të saj.
 7. Mungesa e sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit për këtë program studimi.

8. Infrastruktura fizike në funksion të këtij programi studimi, nuk është e mjaftueshme dhe nuk mbulon sa duhet nevojat e studentëve të këtij programi studimi.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit **Master Profesional** në **“Bankë-Financë”**, të **Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës**, me rekomandimet sipas shtojcës së këtij vendimi.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **2 (dy)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **30/09/2023**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


BORDI I AKREDITIMIT

ARJAN GJONÇA



Kryetar

ALEXANDER KOHLER




Anëtar

FABRICE HENARD




Anëtar

ARBEN MERKOCI




Anëtar

ALEKSANDËR XHUVANI



Anëtar

ANILA PAPARISTO



Anëtar

SULO HADERI *Sulo Haderi* Anëtar

LULJETA MINXHOZI *Luljeta Minxhozi* Anëtar

GËZIM VISOKA *Gëzim Visoka* Anëtar

DRINI IMAMI *Drini Imami* Anëtar

FATMIR GURI *Fatmir Guri* Anëtar

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 14, datë 19.02.2021, “Për akreditimin e parë të programit të studimit **Master Profesional në “Bankë-Financë”**”, të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, janë si vijon:

1. Institucioni, të përshtasë lëndët e këtij programi studimi me nivelin e programeve të studimit të ciklit të dytë Master Profesional, duke përfshirë më tepër lëndë të profilit të Bankë-Financë për t’i ardhur më në ndihmë formimit profesional të studentëve në këtë fushë specifike dhe për të lehtësuar punësimin e tyre.
2. Institucioni, të rekrutojë personel të ri akademik, me tituj dhe grada, për të mundësuar mbulimin e ngarkesës mësimore në masën mbi 70% nga personeli akademik efektiv (PAE) në përmbushje të detyrimeve ligjore.
3. Institucioni, të kryejë një studim të mirëfilltë të tregut të punës në të cilin të analizojë nevojat reale të tregut të punës, duke u krahasuar me programe të ngjashme profesionale në tregun lokal dhe në tregje gjeografikisht afër me shtetin tonë, me qëllim punësimin e studentëve të këtij programi studimi.
4. Institucioni, të rrisë dhe të institucionalizojë marrëdhëniet me biznesin, me qëllim ofrimin e praktikave profesionale dhe mundësi punësimi për studentët e këtij programi studimi, duke përmbushur edhe objektivat e programit.
5. Institucioni, të mbështesë me anë të trajnimeve, zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit akademik të këtij programi studimi në përmirësimin e mësimdhënies dhe kompetencave didaktike.
6. Institucioni, të marrë masa për rritjen e burimeve njerëzore të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe të garantojë pavarësinë e saj, në realizimin e funksioneve sikurse është parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
7. Institucioni, të marrë masa për përdorimit e sistemeve të brendshme të menaxhimit të informacionit, për komunikim, shpërndarje informacioni etj.
8. Institucioni, të përmirësojë infrastrukturën fizike në funksion të këtij programi studimi, me qëllim mbulimin e plotë të nevojave të studentëve për realizimin me sukses të programit të studimit.
9. Institucioni, të pasurojë fondin e bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si edhe përditësimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

